



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
SPITALI UNIVERSITAR  
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania  
Tel/Fax :+355 4 235 4792

[www.sushefqetndroqi.gov.al](http://www.sushefqetndroqi.gov.al)  
[info@sushefqetndroqi.gov.al](mailto:info@sushefqetndroqi.gov.al)

Tirane, me \_\_20/02/2017\_\_

### **Raport**

**Tema : Edukim dhe promocion ne lidhje me semundjen e Tuberkulozit ne qendren e Komunitetit Rome, Tufine – Tirane.**

Ne date 16 shkurt 2017 Programin Kombetar i Tuberkulozit ne bashkepunim me drejtuesit e kesaj qendre te strehimit organizoi nje takim tjetër me banore te ketij komuniteti Rome ne lidhje me edukimn shendetesor per semundjen e TB per shkak te interesit te nje dite me pare ,

Nga takimi i nje dite me pare me pjesemarresit qe kishin qene prezent ne u beme disa pyetje te thjeshta nese ata i kishin lexuar apo jo .Ne konstatuam se ata kishin mesuar mire qe semundja perhapet ndermjet ajrit , si te mbrohen dhe qe ishte plotesisht e sherueshme dhe qe medikamentet ishin falas. Per personat qe kishin deshire por nuk dinin te lexonin u rekomandua qe psikologët dhe personeli shendetesor tjua lexonin dhe shpjegonin sa here ata te kishin nevojë.

Takimi u organizua ne te njejtat ambiente te kesaj qendre ku moren pjese me shume se 25 pjesemarres. Ne kete takim u folë me te njejtin program si nje dite me pare , nese ata kishin degjuar per semundjen e TB , a kishin patur ndonje pjestar te familjes te semure me TB , nese kishin informacion se si duheshin te mbroheshin nga kjo semundje e pyetje te tjera. Infermieri i dispanserise Z.Hysni Popshini dhe kryeinfermierja e edukimit shendetesor per TB ne spitalin Universitar te Mushkerise Znj. Merita Jazezhiu treguan konkretisht se cfare duhet te kishin parasysh per tu mbrojtur nga semundja e TB.

Ne kete takim foli dhe kryetari i tyre zoti Xheladin i cili u shpjegoi se duhet ti degjojne te gjitha dhe ti zbatojne masat e parandalimit te semundjes se TB. Me pas u shperndan fletepajosje jo vetem per pjesemarresit ne takim por per te gjithë banoret Rome te strehuar ne kete qender. Ata bene pyetje te ndryshme nga te cilat kuptuam se vertet me kete takime ata ishin te interesuar te



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
SPITALI UNIVERSITAR  
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania  
Tel/Fax :+355 4 235 4792

[www.sushefqetndroqi.gov.al](http://www.sushefqetndroqi.gov.al)  
[info@sushefqetndroqi.gov.al](mailto:info@sushefqetndroqi.gov.al)

dinim me shume jo vetem per semundjen e TB, por dhe per semundje te tjera infektive. Drejtoresha e kesaj qendre shpreu mirenjohjen per pjesemarrjen tone ne keto takime dhe sa e rendesishme eshte te mbeshtesim me shume kete komunitet me njohuri per te gjitha semundjet por specifikesht per semundjet infektive te komunitetit.

Ne fund te takimit u shperndan fletepalosje per semundjen e Tuberkulozit.

Bashkepunimi midis kesaj qendre, Spitalit Universitar” Shefqet Ndroqi” dhe Programit Kombetar te TB , dispanserive do te forcohet edhe me shume ne te ardhmen.

**Menaxhere e Programit Kombetar te Tuberkulozit**

**Dr.Donika Bardhi Mema**